

FERIT DUKA

**NDRYSHIME NË FIZIONOMINË URBANISTIKE
DHE ARKITEKTURORE TË QYTETIT SHQIPTAR
TË PERIUDHËS OSMANE: DIMENSIONI
ISLAMIKO-ORIENTAL
(SHEK. XVI-XVII)**

Ndryshimet e mëdha që u manifestuan në jetën ekonomiko-politike, si dhe në strukturën demografike e konfesionale të viseve shqiptare gjatë shek.XVI-XVII, përcaktuan edhe tiparet e reja që u dukën në shtrirjen dhe kompozimin urbanistik si dhe veçoritë arkitekturore të qyteteve gjatë periudhës në fjalë. Karakteristikë kryesore e këtyre zhvillimeve është lindja dhe zhvillimi i formacionit islamiko-oriental, si përbërës i rëndësishëm i ansamblit urban të kësaj kohe. Në mënyrë që lënda e këtij punimi të jetë sa më e kuptueshme dhe metodika e paraqitjes sa më e thjeshtë, shqyrtimet dhe analizat tona do të përqendrohen në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë Jugore siç ishin Berati, Vlora dhe Gjirokastra, që të tria qendra urbane të përfshira brenda juridiksionit të sanxhakut të Vlorës (Avlonya livası).

1. Krijimi dhe zgjerimi i mëhallëve myslimane

Islamizimi gjithnjë e më i shpejtë i popullsisë qytetare, do t'i jepte një pamje të re peizazhit urbanistik të qyteteve shqiptare. Element dallues i rëndësishëm i këtij peizazhi duhen konsideruar mëhallët e reja ku vendoset e grupuar popullsia e islamizuar rishtas.

Në se i referohemi qytetit të **Beratit**, mund të thuhet se deri nga fundi i shek. XVI, mëhallët myslimane ishin ende një dukuri e panjohur. Një gjë e tillë duket nga shqyrtimi i të dhënave të defterëve të hollësishëm osmanë të shekullit në fjalë. Sipas një regjistrimi osman të vitit 1520, qyteti në fjalë kishte gjithsej 25 mëhallë të krishtera (përfshirë këtu edhe komunitetin hebraik me 25 shtëpi) dhe asnjë myslimane, ndonëse aty-këtu duket ndonjë banor i islamizuar.¹ 63 vjet më vonë, në vitet 1583,

¹ *Başbakanlık Osmanlı Arşivi* (më tej: BOA), Tapu Tahrir Defterleri, Defteri nr. 99, viti hixhri 926 (1520), f. 23-29. Duhet shënuar se këtu bëhet fjalë vetëm për popullsinë e regjistruar në defter, sepse përndryshe, një përqindje e vogël e

edhe pse në gjendjen demografike dhe në strukturën konfesionale të qytetit shënohen ndryshime të mëdha, në strukturën fetaro-urbanistike këto ndryshime ende nuk kanë gjetur pasqyrim. Sipas një regjistrimi tjetër të bërë në vitin e lartpërmendur, ndërsa popullsia qytetare e krishterë regjistrohet e vendosur në 22 mëhallë, popullsia myslimane e Beratit shënohet thjeshtë si "*bashkësi e myslimanëve të kalasë së Beratit (cemaat-i müslümân-i kala'-i Belgrâd-i Arnavûd)*", e pashpërndarë ende nëpër mëhallët e veta të veçanta.

Ndonëse numri i mëhallëve të krishtera të regjistruara në vitin 1583 është tepër i madh, në numrin e shtëpive të tyre duket një rënie e theksuar, gjë që lidhet me përshpejtimin e procesit të islamizimit të familjeve qytetare. Në vend të personave të veçuar që shfaqen të islamizuar në mëhallë të caktuara në vitin 1520, në vitin 1583 duket se janë krijuar "oazet" myslimane nëpër mëhallët e krishtera të qytetit. Për këtë flet jo vetëm fakti që, siç u theksua më sipër, mëhallët e krishtera janë zvogëluar shumë nga pikëpamja numerike, por edhe fakti tjetër se popullsia myslimane e qytetit është shtuar në përpjesëtime të tilla, sa që në vitin 1583 ka formuar atë që në defterin e këtij viti shënohet si "*bashkësi myslimane e kalasë*". Në këto rrethana nuk duhet të mendohet kurrsesi se me bashkësinë e myslimanëve të kalasë së Beratit ishte krijuar një ose disa mëhallë myslimane në kala. Emërtimi në fjalë ishte shprehje e funksioneve të popullsisë qytetare të islamizuar, funksione që lidheshin me mbrojtjen e mirëmbajtjen e kalasë dhe jo me vendbanimin e saj. Vetë mëhalla tradicionale e Kalasë, mbeti në vetvete si mëhallë e paislamizuar, gjë për të cilën flasin edhe të dhënat dokumentare të shekullit vijues.

Të dhënat e defterit osman të vitit 1583 janë të rëndësishme jo vetëm që tregojnë se deri në këtë moment në qytetin e Beratit nuk ishin krijuar ende mëhallët e veçanta myslimane, por edhe sepse na bëjnë të ditur që ndryshimet në gjendjen demografike (shtimi i popullsisë qytetare) dhe në strukturën fetare të popullsisë (shtimi dhe mbisundimi numerik i popullsisë myslimane ndaj popullsisë së krishterë), përgatitën kushtet që këtej e tutje shumë mëhallë të krishtera të shndërroheshin gradualisht në mëhallë myslimane.

Shumësia e mëhallëve që regjistroheshin për qytetin e Beratit në vitin 1583, të krijon bindjen se hapësira urbane tashmë ishte zgjeruar pak a

islamizuar e popullsisë, e inkuadruar në funksione administrative, këtu nuk është regjistruar.

shumë në kufij të qëndrueshëm, ndaj dhe mëhallët e reja myslimane që filluan të krijohen pas kësaj kohe, nuk sollën ridimensionime të ndjeshme të saj. Madje, siç del nga defteri i vitit 1583, në gjysmën e dytë të shek. XVI, ekzistonte edhe një mëhallë përtej Osumit (Gorica).²

Emërtesa e mëhallëve të Beratit në shek.XVI bart karakteristikat e një qyteti zejtar në zhvillim e sipër. Disa mëhallë mbanin emrat e njerëzve të shquar të qytetit, nga hierarkia politike dhe ajo fetare, nga sfera zejtare, etj. Është mjaft domethënëse në këtë drejtim ekzistenca e një mëhale të veçantë të formuar prej meremetuesve dhe hekurpunuesve (meremetçi ve haddad) që nga viti 1520, si edhe e mëhallëve të tjera me emra zejtarësh ose priftërinjsh (Petri Litarpunuesi, Papa Kondi, etj.)

Për sa i përket qytetit të **Vlorës**, duhet thënë se ashtu si dhe Berati, ajo ishte ndër të parët qytete të Shqipërisë që u përfshi brenda rrezes së sundimit osman. Në vitin 1417 ky qytet bashkë me Kaninën, iu dorëzua osmanllinjve nga ana e sundimtares lokale Rugina Balsha.³

Regjistrimet osmane për sanxhakun e Vlorës, që kanë mbërritur deri në ditët tona i përkasin fundit të shek.XV (kohës së sulltan Bajazitit II) dhe shek.XVI. Është fjala për defterë përmbledhës (mücmel, icmâl) dhe të hollësishëm (mufassal) që përmbajnë të dhëna të çmuara për qytetin dhe për krejt sanxhakun⁴.

Falë pozitës gjeografike si dhe vendit të privilegjuar që zinte në planet politike dhe ushtarake të shtetit osman, Vlora në shek.XVI renditet ndër qytetet që shfaqin një zhvillim të shpejtë ekonomik e shoqëror. Dinamika e këtij zhvillimi duket, pikësëpari, në tiparet origjinale të evolucionit demografik të qytetit. Të dhënat e defterit të hollësishëm të regjistrimit të vitit 1520⁵ flasin për një rritje befasuese të numrit të

² Për këtë mëhallë duhet të jetë fjala kur përmendet në defter me emrin: *Mëhalla e Jashtme (Mahalle-i Hariç)* me 44 shtëpi. Duket se kjo mëhallë nuk ka ekzistuar në dhjetëvjeçarët e parë të shek.XVI, pasi në defterin e vitit 1520 ajo nuk përmendet.

³ *Historia e Shqipërisë*, vëll.I, Tiranë: 1959, f.248.

⁴ Këta defterë ruhen në arkivat e Stambollit dhe të Ankarasë, ndërsa një pjesë e tyre janë sjellë të fotokopjuara dhe ruhen në arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë.

⁵ *İstanbul Başbakanlık Osmanlı Arşivi, Tapu Tahrir Defterleri* (më tej: *IBOA, TTD*), Defteri nr.99, f.5-9.

popullsisë qytetare. Nga 762 shtëpi që numëronte qyteti në vitin 1506⁶, në vitin 1520 regjistron 1 367 shtëpi.

Duket qartë se një rol të veçantë në rritjen demografike të qytetit ka luajtur krahas vërshimit drejt tij të popullsisë së fshatrave të rrethinës edhe ardhja nga Perëndimi e një numri të madh azilantësh hebrenj⁷. Për sa i përket faktorit të parë, d.m.th zhvendosjes drejt qytetit të popullsisë rurale, duhet theksuar se ai vihet re si dukuri shumë më herët se disa qytete të tjera siç janë Berati dhe Elbasani, në të cilat ngulimi masiv i banorëve me origjinë nga rrethina fshatare dokumentohet vetëm në dhjetëvjeçarët e gjysmës së dytë të shek. XVI⁸. Kjo tregon më së miri se qyteti i Vlorës kishte hyrë më herët në rrugën e zhvillimit të shpejtë shoqëror-ekonomik se sa qytetet e tjera të lartpërmendura. Në mesin e popullsisë së ardhur nga rrethinat e qytetit një vend të dukshëm zënë banorët e zhvendosur nga Kanina, një nga qendrat urbane dhe ushtarake të njohura të Mesjetës⁹, roli dhe rëndësia e së cilës në këtë kohë po vinte duke u zbehur për llogari të Vlorës. Ndërsa pjesa tjetër e popullsisë fshatare të vendosur në qytet, ishte nga fshatrat Palasë, Nartë, Drashovicë etj¹⁰.

Sikundër theksuam më lart, një pjesë e mirë e popullsisë vlonjate përbëhej nga hebrenjtë (531 shtëpi), gjë që tregon se qyteti i Vlorës u bë në këtë kohë edhe një nga pikat më të rëndësishme të përqendrimit të refugjatëve hebrenj të dëbuar nga Spanja, Portugalia dhe vende të tjera të Perëndimit dhe të pranuar nga sulltanët osmanë për t'u vendosur në territoret e Perandorisë¹¹. Shtimi i shpejtë i valëve të eksodit hebraik drejt Lindjes pasqyrohet qartë në ndryshimin e shpejtë të numrit të banorëve hebrenj të regjistruar në qytetin e Vlorës. Nga 97 shtëpi hebrenjsh në vitin 1506, më 1520 regjistrohen 531 shtëpi ose 39% e numrit të përgjithshëm të shtëpive të qytetit¹². Vlerësuar nga përqindja e popullsisë hebreje, Vlora në këtë kohë linte prapa qendra të rëndësishme të

⁶ IBOA, TTD, Defteri nr.34, f.3.

⁷ Po aty, Defteri nr.99, f. 5-9.

⁸ Ferit Duka, *Berati në kohën osmane (shek. XVI-XVIII)*, Tiranë: "Toena", 2000, f.25.

⁹ IBOA, TTD, Defteri nr.99, f.9.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Ferit Duka, "Hebrenjtë në Shqipëri. Bashkësitë e Vlorës dhe të Beratit (shek. XVI-XVIII)", *Studime historike*, nr.3-4, Tiranë: 2002, f.13-14.

¹² Po aty, f.14-15.

Perandorisë Osmane të banuara nga hebrenj, siç ishin vetë kryeqyteti i Perandorisë Stambolli, qytete të tilla të rëndësishme si Manastiri, Shkupi, Tërhallë, Serezi, Edirneja, Bursa etj., duke u vendosur menjëherë pas kryeqendrës hebreje të Ballkanit, Selanikut¹³.

Qyteti i Vlorës paraqet një tipar specifik mjaft të rëndësishëm kur është fjala për përkatësinë fetare të popullsisë qytetare. Ndryshe nga shumë qytete të tjera shqiptare, popullsia e të cilave pas vendosjes së sundimit osman në një pjesë të madhe të saj, iu nënshtrua procesit të islamizimit, Vlora, të paktën deri në vitin 1583, ka ruajtur homogjenitetin e krishterë të popullsisë vendase (këtu nuk flitet për parinë e islamizuar ose banorët hebrenj).¹⁴ Rrjedhimisht për këtë qytet nuk mund të flitet as për krijimin e *bashkësisë së myslimanëve*, siç kishte ndodhur në Berat, e jo më për mëhallë të veçanta myslimane.

Një dinamikë interesante vihet re edhe në zhvillimet e qytetit të **Gjirokastrës** gjatë shek. XV-XVI. Duket qartë se treguesit demografikë dhe ekonomikë të qytetit në fillimet e erës osmane në Shqipëri ishin tepër modestë. Nga kjo pikëpamje Gjirokastra mbetet pas qyteteve të tjera të kohës të regjistruara në këtë defter. Kështu p.sh. Kanina numëronte 216 shtëpi,¹⁵ Berati 175¹⁶, etj. Kjo do të thotë se roli politik dhe administrativ i qytetit të Gjirokastrës në këtë kohë nuk përputhej me nivelin ende të ulët të zhvillimit ekonomik e demografik të qytetit.

Afër një shekull më vonë, një tjetër dokument i rëndësishëm, *defteri i hollësishëm osman i regjistrimit të livasë (sanxhakut) së Vlorës të vitit 1520*,¹⁷ na paraqet më shumë të dhëna për qytetin e Gjirokastrës. Tashmë, si rrjedhojë e ndryshimeve politike dhe administrative që kishin ndodhur

¹³ Po aty, f.15.

¹⁴ *Ankara Tapu ve Kadastro Genel Müdürlüğü Arşivi* (më tej: *ATKGMA*), Defter-i mufassal-i liva-i Avlonya, nr.62, f.9-13. Ndryshe nga ç'kemi pohuar më lart, studiuesi J. Veinstein duke iu referuar defterit osman të sanxhakut të Vlorës të vitit 1520, përmend një kontigjent popullsie myslimane të qytetit prej 85 shtëpish. (shih: Jilles Veinstein, "Avlonya (Vlorë), une étape de la voie Egnatia dans la seconde moitié du XVIe siècle", Elizabeth Zachariadou (ed.), *The via Egnatia under Ottoman rule*, Crete University Press, Rethymnon: 1996, f.218). Nga shqyrtimi që i kemi bërë këtij defteri, një gjë e tillë na rezulton e pavërtetë (shih për këtë: *IBOA*, TT, Defter-i mufassal-i liva-i Avlonya, nr.99, f.5-14).

¹⁵ Po aty, f.33.

¹⁶ Po aty, f.55.

¹⁷ *BOA*, Defter-i Mufassal-i Liva-i Avlonya, nr.99, viti H.926/1520.

në tokat shqiptare pas vendosjes përfundimtare të sundimit osman, Gjirokastra ishte qendër e kazasë me të njëjtin emër, e cila nga ana e saj ishte pjesë përbërëse e sanxhakut të Vlorës.

Qyteti është regjistruar si pjesë përbërëse e timareve të spahinjve të kazasë dhe jo si pjesë e haseve të funksionarëve të administratës. Hapësira urbane ishte ndarë në 8 mëhallë.

Në regjistrimin e vitit 1583¹⁸ paraqitet gjithashtu e plotë dhe e qartë pamja urbanistike, demografike, sociale dhe fetare e këtij vendbanimi në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XVI. Ashtu si në qytetin e Beratit, edhe këtu tashmë ekzistonte si pjesë e veçantë e popullsisë qytetare *bashkësia (xhemaati) e myslimanëve* të qytetit e përbërë nga 63 vetë (kryefamiljarë). Pranë shumicës së këtyre emrave janë shënuar edhe profesionet dhe zejet që ata ushtronin. Në krye të listës emërore ndodhen klerikët e besimit islam të qytetit: Ahmedi, hatib; Mustafa Çam-i(?), halife; Mehmed Leka (?), imam; Mustafa Rustem-i, muezin; Mustafa Balliu, imam dhe Mehmed Balliu, imam. Nga këto shënime del e qartë se tashmë është formësuar jo vetëm bashkësia myslimane në kuadër të popullsisë qytetare, por edhe hierarkia fetare islame. Kjo do të thotë se, pavarësisht se nuk pasqyrohen në defter për shkak të natyrës së vetë dokumentit, në qytet ekzistonin dhe funksiononin edhe objekte të kultit islam, si xhami, mesxhide etj.

Tashmë dalin në pah gjithashtu edhe zejet karakteristike me të cilat merrej popullsia myslimane e qytetit. Këpucaria dhe punimi i lëkurës janë zejet kryesore që ushtronte bashkësia në fjalë. Por ajo që tërheq vëmendjen në këtë rast është fakti se krahas profesioneve të tjera, në defterin osman të vitit 1583 përmendet edhe ai i *arkitektit* (Muradi, arkitekt), gjë që tregon se niveli i kërkesave të bashkësisë qytetare në pikëpamje të arkitekturës dhe urbanistikës tashmë ishte më i lartë.¹⁹

Duhet theksuar se, ndryshe nga Berati dhe Vlora, Gjirokastra, që në këtë kohë, përveç grupit të popullsisë qytetare, që në defter regjistrohet me emërtimin "*bashkësia e myslimanëve*", kishte një mëhallë të veçantë myslimane me një pjesë të vogël të banorëve të islamizuar, e cila mban emrin "Martollos" (mahalle-i Martolos).²⁰ Në këtë rast emri i mëhallës duhet të lidhet me vetë funksionin që kishin kryer më parë banorët e saj.

¹⁸ *ATKGMA*, Defter-i Mufassal-i Liva-i Avlonya, nr.62, H.991/1583.

¹⁹ *Po aty*.

²⁰ *Po aty*, f.127/a.

Zakonisht martollosët ishin grupe të caktuara personash të krishterë që ngarkoheshin nga administrata osmane me shërbime të ndryshme ushtarake, siç ishin ruajtja e kalave dhe e pozicioneve të tjera strategjike etj. Kundrejt shërbimit ushtarak që kryenin, ata shpërbleheshin nga ana e autoriteteve osmane (zakonisht secili merrte një pagë ditore prej 2 akçesh) dhe në shumë raste faleshin edhe nga detyrimet dhe taksat (muâf ve müselleme) që duhet t'u paguanin timariotëve ose shtetit osman për bashtinat që kishin në përdorim.²¹ Duket se banorët e kësaj mëhalle më parë kishin pasur statusin e martollosëve, status që duhet të ketë ndikuar që më pas të linin fenë e krishterë dhe të përfaqonin Islamin. Gjithsej në mëhallën "Martollos" janë regjistruar 14 individë, prej të cilëve 3 janë shënuar me inicialen "ç" (çift), d.m.th. zotëronin sipërfaqe toke në madhësinë e një çiftligu (pronë e zakonshme e një familjeje bujqësore të kohës). Tri veta të tjerë janë regjistruar si "benakë", d.m.th., kishin shumë më pak tokë se kategoria e shënuar si "çift". Pjesa tjetër e banorëve të mëhallës janë shënuar si beqarë (myxherred). Këtë status e mban edhe i vetmi banor i krishterë i kësaj mëhalle, Deda Jani.²²

Në shek. XVII uniformiteti i krishterë i peizazhit urbanistik, kishte filluar të cenohej; kështu, gjatë rrjedhës së këtij shekulli, në qytetin e **Beratit** krijohen e zhvillohen një sërë mëhallësh myslimane, duke e ngushtuar gjithnjë e më shumë hapësirën e banuar prej elementit të krishterë. Në gjysmën e shekullit në fjalë varfëria e dokumentacionit e vështirëson konstatimin e kësaj dukurie në gjerësinë e duhur. Megjithatë, në ndonjë rast shohim të shfaqen edhe gjatë kësaj kohe mëhallë myslimane të sapokrijuara. Kështu, për shembull, që në vitin 1647/1057 përmendet në një dokument mëhalla *Vojvoda*, si një prej mëhallëve të qytetit të Beratit²³. Ndoshta më të vjetra se kjo në këto kohë ishin mëhallët *Xhamia e Vjetër* dhe *Pazari i Vjetër*. Me këtë duhet të ketë lidhje fakti që në dokumentet e mëvonshme, e para quhet ndryshe edhe

²¹ Për martollosët dhe rolin e tyre në strukturën ushtarake osmane në Ballkan më gjerësisht shih: Halil Inalcık, *Osmanlı İmparatorluğu, Toplum ve Ekonomi*, Istanbul: Eren, 1993, f.103-105; Ferit Duka, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare (Studime dhe dokumente)*, Tiranë: UET Press, 2009, f. 229-230

²² Edhe ky fakt të bën të mendosh se procesi i kalimit në Islam i banorëve të mëhallës "Martollos" ishte një dukuri shumë e afërt nga pikëpamja kohore.

²³ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi 128, dos.10, f.18.

Mëhalla e Vjetër (Mahalle-i Atik, Eski Mahalle), emër të cilin ajo e mori nga xhamia e ndërtuar aty për nder të sulltan Bajazitit II.²⁴

Vetëm në gjysmën e dytë të shek. XVII dhe pikërisht në vitin 1670, pamja urbanistike e Beratit paraqitet e tillë që mëhallët myslimane tregojnë një rritje numerike më të madhe kundrejt mëhallëve të krishtera, numri i të cilave është zvogëluar shumë falë islamizimit të shpejtë të popullsisë qytetare. Sipas njoftimeve të E. Çelebiut, që i përkasin vitit në fjalë, qyteti kishte 30 mëhallë, nga të cilat 19 prej tyre ishin myslimane, 10 të krishtera dhe 1 hebreje.²⁵ Ndër mëhallët kryesore, sipas këtij burimi, përmenden mëhallët Murat Çelebi, Uzgurlu, (formë e turqizuar e emrit “Zguro” – F.D.), Hynqar (Mbret), Vakëf, Baba Kadi, Bashmakçinjte, Mexhidi i Bardhë, Pazari i Vjetër, Gyn Gërmez (është fjala për mëhallën e Goricës, e cila ngaqë nuk e zinte dielli, thirrej “mëhallë që nuk sheh diell”: Gün Görmez mahallesi –F.D.).²⁶

Më 1687 janë regjistruar zyrtarisht me rastin e pagimit të taksës së sursatit 23 mëhallë të njohura me këto emërtime: Mandall (emri i plotë i Mandall Mehmed bej-F.D.), Izgurzade (i biri i Zguros – F.D.), Izgur Ahmet bej (Ahmet bej Zguro- F.D), Baba Kadi, Ustadoglu (i biri i ustait – F.D), Haxhi Sinani, Hysen Gjala; Çengjane (e ciganëve – F.D), Xhamia e Vjetër, Mesxhidi i Bardhë, Sikush, Pazari i Vjetër, Kara Kasem, Hëçek, Haxhi Sulejman, Gyn Gërmez (Gorice), Ura e Bardhë, Murat Çelebi, Kara Alibej, Deli Bega, Mangalem, Mëhalla e Re (Cedid), Çermelos.²⁷ Në një numër tjetër të këtij lloji janë përmendur veç mëhallëve të mësipërme edhe mëhallë Budinli.²⁸ Në rastet e lartpërmendura nuk është

²⁴ Kjo bëhet e qartë edhe kur në dokumente thuhet: “Xhamia e sulltan Bajazitit në Mëhallën e Vjetër (Mahalle-i Atik)”. Shih: *AQSH*, Fondi 128, dos. 48, fl. 30.

²⁵ Shifra që jep Evlija Çelebiu, ndonëse duket e zmadhuar po të ballafaqohet me të dhënat e dokumentacionit, flet për rritje të konsiderueshme të qytetit të Beratit. Shih: Evlija Çelebi, *Seyyahatnamesi*, cilt. 8, Istanbul: 1928, f. 693.

²⁶ Krahas emërimit turk “Gün Görmez”, në dokumentet osmane të kohës, ndonëse rrallë, është përmendur edhe emërtimi “Goricë”, me të cilin thirrej zakonisht mëhalla në fjalë. Kështu për shembull në dy dokumente trashëgimie të vitit 1674 (përkatesisht për tregtar Mehmetin dhe një grua të quajtur Fatma) kjo mëhallë përmendet me emrin “Goricë” (*Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), L.854, dos.3, fl. 968-969).

²⁷ *AQSH*, Fondi 128, dos.3, fl.103.

²⁸ *Po aty*, f.114.

përfshirë në listat e mëhallëve edhe Kalaja, e cila me sa duket ishte përjashtuar nga detyrimet për të cilat janë përpiluar ato.

Sigurisht që numri i mëhallëve të qytetit ishte i lëvizshëm, sepse edhe koncepti për madhësinë dhe shtrirjen e tyre ishte i ndryshueshëm. Kjo duket në faktin që në dokumentacionin e shek. XVII-XVIII gjejmë të shënuara si mëhallë të veçanta edhe mëhallë të tjera, të cilat janë derivate të mëhallëve që u përmendën më sipër. Si të tilla mund të përmenden mëhalla e Tabakhanës (Debaghane mahallesi)²⁹, mëhalla e Ramoglusë (e të birit të Ramos)³⁰, mëhalla Çardak³¹, etj.

Emërtimet e disa mëhallëve myslimane të qytetit lidheshin me njerëz të shquar të shtresave të larta qytetare, të cilët u jepnin emrin e vet mëhallëve që krijoheshin në pronat e tyre (Murat Çelebi) ose përreth objekteve të kultit islamik që ata ndërtonin (Mandall Mehmet bej, Kara Ali bej, Ahmet beu, i biri i Zguro, Mehmet beu, i biri i Zguro³², Deli Bega, etj.). Ndonjëra prej mëhallëve mbante edhe emrin e objektit të kultit rreth të cilit ishte ndërtuar, siç ishin për shembull mëhallët Xhamia e Vjetër, Mexhidi i Bardhë etj. Emërtimet e mëhallëve të tjera lidheshin edhe me veprimtarinë zejtarë-tregtare, si për shembull mëhalla Ustadoglu (i biri i ustait), Pazari i Vjetër, etj.

Një gjë e tillë ndodhi edhe me mëhallën Kala, derivatet e së cilës përmenden dendur në dokumentet osmane si mëhallë të veçanta, duke marrë emrat e kishave që ndodheshin këtu, si për shembull: mëhalla e Shën Bitrit³³, mëhalla e Vangjelistrës³⁴, ato të Shën Mërisë³⁵, Shën Gjergjit, etj.³⁶

²⁹ *Po aty*, dos.7, fl.54.

³⁰ *Po aty*, dos.8, fl.41.

³¹ *AIH*, L.854, dos.8, fl.41.

³² Ahmet bej Zguro dhe Mehmet bej Zguro (osmanisht: Izgur ose Uzgur) duket se ishin dy pinjollë të islamizuar të një familjeje feudale të Beratit, *Skurajve* (*Zgurajve*), emri i së cilës jo vetëm që nuk humbi me pushtimin osman të Shqipërisë, por u trashëguua me dinjitet prej pasardhësve të saj, të cilët arritën të ngjiten deri në shkallët e larta të hierarkisë shtetërore osmane, sikurse shihet në rastin e këtyre dy përfaqësuesve të familjes së lartpërmendur.

³³ *AQSH*, Fondi 128, dos.3, fl.21.

³⁴ *Po aty*, fl.43.

³⁵ *Po aty*, fl.9.

³⁶ *Po aty*, dos.15, f.28.

Në shek. XVII, ekzistenca e mëhallëve myslimane ishte bërë një dukuri karakteristike edhe për **Vlorën**. Kjo lidhet me kalimin në Islam të një pjese të popullsisë së këtij qyteti gjatë shekullit në fjalë. Siç kuptohet nga njoftimet e udhëpërshkruesit osman E. Çelebiu, në Vlorë ekzistonin disa mëhallë me emra myslimanë siç ishin mëhalla e Xhamisë së Hynqarit, e Tabakëve, e Hysen Agait, e Mahqemesë, etj.

2. Transformime në arkitekturën e qyteteve: monumentet e kultit islam

Një element i rëndësishëm i strukturës urbanistike të qytetit të Beratit në shek. XVII-XVIII ishin objektet e *kultit islam*, si xhami, mesxhide (xhami të vogla pa minare), medrese, teqe, zavije (teqe të vogla), etj. Duke filluar sidomos nga gjysma e dytë e shek. XVII, ndërtimet islamike në Berat përherë e më tepër ndikojnë në siluetën e qytetit dhe më gjerë në organizimin e tij urbanistik. Sipas shpjegimeve të Çelebiut, në vitin 1670 në qytetin e Beratit numëroheshin 30 faltore myslimane, ndër të cilat kryesorja ishte ajo që i takonte tërë komunitetit të besimtarëve myslimanë: xhamia e sulltan Bajazit Veliut (e quajtur më vonë edhe Xhamia e Vjetër).³⁷ Nga vetë emri i xhamisë në fjalë merret vesh se ndërtimi i saj u bë në kohën e mbretërimit të sulltan Bajazitit II dhe se fillimet e kësaj vepre duhet të lidhen me kohën e kalimit të sulltanit në këto vise për të mbikëqyrur gjendjen dhe veprimet ushtarake të trupave osmane. Xhamia e Vjetër (më vonë u quajt Xhamia Mbret - F.D.), sipas Çelebiut, ishte 60 këmbë e gjatë dhe 50 këmbë e gjerë, me një minare të lartë e të bukur. Përpara kishte një sofat të madh, ndërsa oborrin e kishte të ngushtë. Xhamia në fjalë kishte tri dyer anësore dhe një qendrore që dilte në sofat. Ajo ishte e ndërtuar sipas stilit të vjetër dhe e mbuluar tërësisht me tjegulla.³⁸ Xhamisë iu bë një rindërtim nga fundi i shek. XVII-fillimi i shek. XIX dhe sot është vështirë të dallohet se çfarë i përket ndërtimit të vjetër dhe çfarë rindërtimit. Nga ndërtesa e vjetër është ruajtur deri vonë minarja e hollë dhe e lartë.³⁹

Një nga monumentet më të rëndësishëm të kësaj kohe në Berat ishte edhe xhamia e ndërtuar prej Ahmet bej Zguros (Uzkurllu xhami). Si

³⁷ Evlija Çelebi, *Seyyahatnamesi*, f. 693.

³⁸ *Po aty*.

³⁹ Më gjerësisht për këtë shih: Apollon Baçe, Aleksandër Meksi, Emin Riza, *Berati. Historia dhe arkitektura*, Tiranë: 1988, f. 56-57.

një nga ndërtimet më të hershme të kultit islamik të qytetit (ndërtuar në vitet 1558-1554),⁴⁰ ajo shquhet për tiparet e veta interesante të arkitekturës. Xhamia në fjalë, e cila në dokumentet historike të kohës përmendet me emrin “Xhamia e Ahmet bej Zguros”⁴¹ ose “Xhamia e Plumbit”⁴², në vitin 1670 përshkruhet si një ndërtesë mjaft e bukur me një kube qargjir⁴³, të mbuluar krejtësisht me plumb të pastër ngjyrë blu, kishte një minare të lartë e të hijshme, saqë krahasohej me xhaminë e *Milk Gaziut*, në qytetin Niksar të ejaletit të Sivasit në Anadoll. Në sofatet anësore të hajatit të kësaj faltoreje ngriheshin kolona prej mermeri të bardhë e të ndritshëm, mbi të cilat ishin vendosur shtatë kube të mbuluara me plumb. Të mbuluara me plumb ishin gjithashtu edhe medreseja, teqeja dhe imaretet pranë kësaj xhamie.⁴⁴

Në pikëpamje të tipologjisë arkitekturore, xhamia e Plumbit në qytetin e Beratit grupohet në një radhë me xhaminë e Mirahorit në Korçë, të Muradies në Vlorë, të Gjini Aleksit në Delvinë, të Allajbegisë në Peshkopë, etj., të gjitha të ndërtuara në shek. XV-XVI. Ajo përfaqësonte në Berat të parën xhami të vogël monumentale karakteristike për vendet e Ballkanit, me kupolë sferike dhe portik përpara hyrjes, ndryshe nga xhamitë e ndërtuara në Berat deri atëherë.⁴⁵ Simotra të xhamisë së Plumbit në Berat, gjithnjë në rrafshin e tipologjisë arkitekturore, janë

⁴⁰ Vehxhi Buharaja, “Mbishkrimet turko-arabe të vendit tonë si dëshmi historike”, *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë: 1968, II, f. 81-85.

⁴¹ *AQSH*, Fondi 128, dos.7, H.8, fl.136-137.

⁴² *Po aty*, dos.116, fl.22.

⁴³ Termi “qargjir” është me origjinë persiane. Sipas Sami Frashërit, termi në fjalë ka kuptimin e murit me gur ose me tulla. Me fjalë të tjera cilësoni “qargjir”, sipas Samiut, nënkuptonte çdo ngrehinë me mur guri ose tulle, për t’i dalluar prej ngrehinave prej druri (shih: Şemsettin Sami, *Kamûs-i Turki*, Dersadet (Stamboll), 1317 (1901), f.1137). Pothuajse i njëjti shpjegim gjendet edhe në fjalorin e D.Kelekjanit, veçse shprehur më shkurt: “ndërtesë prej guri ose tulle” (Diran Kelekian, *Dictionnaire Turc-Français*, Istanbul: 1927, f.1005). Me sa duket E. Çelebiu në rastin tonë konkret cilësoni “qargjir” e përdor në kuptimin “prej guri” – “me mur guri”, përderisa ai këtë karakteristikë ua atribuon pothuajse të gjitha ndërtimeve publike e private në Berat.

⁴⁴ Evlija Çelebi, *Seyyhatnamesi*, f. 699.

⁴⁵ Gjergj Frashëri, Sulejman Dashi, “Karakteristika arkitektonike të disa xhamive në vendin tonë”, *Monumentet historike në vendin tonë*, Tiranë: 1978, f. 41-45; Sulejman Dashi, “Një xhami e vjetër në Berat”, *Monumentet*, 15-16, 1978, f.101.

konsideruar prej historianëve tanë të arkitekturës edhe xhamia e sulltan Mehmetit II-Fatihut në Prishtinë, Is'hak Xhamia në Manastir, ajo e Muslihudin Çejrekçisë në Sarajevë, Allaxha Xhamia në Foçë, ajo e Karagjoz Beut në Mostar, etj.⁴⁶

Xhami të tjera të rëndësishme që përmenden në qytetin e Beratit të paktën që prej gjysmës së dytë të shek. XVII e këtej, janë xhamia e Gazi Murat Pashës, një faltore e thjeshtë dhe e hijshme, xhamia e Çelebi Hysen Pashës, nipit të Kara Murat Pashës, në mëhallën Murat Çelebi, e ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. XVII (mbishkrimi në portën e hyrjes tregon si datë të ndërtimit të kësaj xhamie vitin 1081-1670).⁴⁷

Vëmendjen e vëzhguesve të kohës e ka tërhequr edhe xhamia e Hysen Pashës, konsideratat për të cilën E. Çelebiu (xhamia në fjalë sapo ishte ndërtuar kur ai erdhi në Berat) i ka paraqitur në këtë mënyrë: *Është një xhami me minaret gjashhtë-faqëshe, elegante dhe e bukur, qargjir me kube të bukura, e tëra në blu, me një çati të mbuluar me tjegulla në të kuqe të thellë. Është xhami me pamje magjepsëse, elegante, e bukur dhe që nuk ka shoqe në pikëpamje të diturisë arkitektonike; një xhami e ndritshme, që të qetëson e të shlodh.*⁴⁸ Nga i njëjti burim mësohet se pranë gjykatës (së sheries-F.D.) po ndërtohej edhe një xhami e quajtur “Xhamia e Mushkës”. Këto xhami përmenden si faltore të shënuara të qytetit.⁴⁹ Po ashtu nga një dokument osman i vitit 1681 mësohet se në qytetin e Beratit ka ekzistuar edhe një xhami tjetër, e cila ishte ndërtuar prej Baba Kadiut,⁵⁰ ndoshta në mëhallën me të njëjtin emër.

Xhamive të mësipërme u shtoheshin edhe një numër jo i vogël mesxhidesh (faltore të vogla islamike pa minare). Ndërsa xhamitë ndërtoheshin në pika të rëndësishme të qytetit, ku edhe numri i besimtarëve ishte i madh, mesxhidet, si faltore më të vogla, ngriheshin në çdo mëhallë, duke qenë kështu sa më afër besimtarëve për të plotësuar nevojat fetare edhe në ato vende që nuk i kapte rrezja e xhamive. Mesxhidet, duke qenë faltore me arkitekturë të thjeshtë, ndërtoheshin më shpejt. Ato kënaqnin kështu në kohën e duhur kërkesat e popullsisë

⁴⁶ Aleksandër Meksi, “Ndërtimet e kultit mysliman në Shqipëri”, *Studime historike*, nr.1, 1980, f. 199.

⁴⁷ E. Çelebi, *Seyyahatnamesi*, f. 694.

⁴⁸ *Po aty.*

⁴⁹ *Po aty.*

⁵⁰ *AQSH*, Fondi 128, dos. 49, fl.127.

myslimane që sa vinte e shtoj si rrjedhojë e përparimit të shpejtë të fesë islame në radhët e popullsisë qytetare të Beratit.

Informatat e para për mesxhidet, ashtu si edhe për objektet e tjera të kultit islamik në qytetin e Beratit, i marrim nga vepra e E. Çelebiut⁵¹ si dhe dokumentet osmane të kohës.⁵² Sipas këtyre burimeve, mesxhide kishte në mëhallët Vakëf, Murat Çelebi (në këto mëhallë ishin ndërtuar deri në vitin 1670 tri mesxhide), Baba Kadi, Mëhalla e Bardhë, Pazari i Vjetër, Gorica, Izgur Zade Mehmed Bej, Mangalem, Mandall Mehmet Bej, Jevgjitët (sot: egjiptianë - F.D.), Mëhalla e Re (Mahalle-i Cedid ose Yeni Mahalle), Deli Bega, Haxhi Efendi, Sikush, Ustadoglu, Kara Ali Bej, etj.

Një dukuri karakteristike e urbanistikës dhe e arkitekturës së qytetit të Beratit në harkun kohor që përfshin gjysmën e dytë të shek. XVII dhe gjysmën e parë të shek. XVIII, është ndërtimi i përsheptuar i xhamive të reja, krahas xhamive dhe mesxhideve që u përmendën më lart. Me këtë shpjegohet fakti që gjatë kësaj kohe në dokumentacionin historik gjenden njoftime të shumta për ekzistencën e xhamive të panjohura deri më sot në literaturën tonë historike, e cila është mbështetur pothuajse kryekëput në të dhënat e E. Çelebiut dhe në të dhënat epigrafike të zbuluara e të deshifruara prej orientalistit Vexhi Buharaja. Xhami të tilla, për të cilat s'kemi mundur të mësojmë asgjë më tepër përveç emrave të tyre, që shfaqen herë pas here në dokumentet e hulumtuara (për fat të keq asnjë shenjë s'ka mbetur sot prej tyre që të mund të thuhej diçka më tepër) janë këto: xhamia e El-haxh Sulejmanit (emrin e saj e mori edhe një mëhallë që ndodhej pranë), xhamia e mëhallës Deli Bega, xhamia e mëhallës Mandall Mehmet Bej, xhamia e mëhallës Izgurzade Mehmet Bej, xhamia e Hysen Goranës (në mëhallën El-haxh Sinani), xhamia e Kara Kasemit (në mëhallën me të njëjtin emër), xhamia e Azis Goranit, xhamia e mëhallës Vakëf, xhamia e mëhallës së Re dhe xhamia e ndërtuar prej vezirit të madh Mehmet Pasha (duhet të jetë fjala për Mehmet Pashë Qyprlyun e famshëm me prejardhje nga Roshniku i Beratit-F.D.).⁵³

⁵¹ Evlija Çelebi, *Seyyahatnamesi*, f.694.

⁵² Shih ndër të tjera këto dokumente: AQSh, Fondi 128, dos.1, fl.293; dos.8, fl. 213, 306-307; dos.7, fl.43, 55, 59, 170-171; dos.5, fl. 1952-1953; dos.9, fl. 281-282; dos.3, fl. 852-853; dos.5/a, fl.4; dos.8, fl. 348-349; dos. 7, fl.150-151.

⁵³ *AIH*, dos.1, fl. 76-77; dos. 7, fl. 357, 148-149, 60-61; dos.10, fl. 589; dos. 6, fl. 512-513; dos. 9, fl. 103, 211-212, 281-282, 375-376; 366; dos. 3, fl. 966; dos. 6,

Në vitin 1760 u ndërtua një xhami tjetër në fshatin Velabisht në afërsi të Beratit. Edhe xhamia e Velabishtit dallohej për zgjidhje të goditura në rrafshin arkitektonik, ku bie në sy aftësia e ndërtuesve për zgjidhjen e strukturave. Në këtë pikëpamje janë konstatuar analogji të saj me xhami të tjera, të ndërtuara një shekull e ca më parë, siç ishin xhamia Muradije në Vlorë dhe xhamia e Nazireshës në Elbasan.⁵⁴ Xhamia e Velabishtit përbëhej prej sallës së lutjeve me përmasa 6.90 x 6.90 m, të mbuluar me kupolë me tambur me trampë në qoshe. Hyrja për në sallë ishte në anën veriore. Ajo mbulohej me hark të ulët dhe bashkë me portën përfshihet në një portal katërkëndësh. Në anën veriore kishte edhe portën prej druri. Xhamia e Velabishtit shquan për përpjesëtime të hedhura, të cilat janë karakteristike për mjaft xhami të shek. XVIII në vendin tonë.⁵⁵

Është e natyrshme që ndërtimi i xhamive në qytetin e Beratit të ketë filluar nga Kalaja e pastaj të shtrihej në pjesën e poshtme të qytetit. Prandaj edhe xhamitë më të hershme gjendeshin pikërisht këtu. I vetmi burim nga i cili mësohet për herë të parë në lidhje me ekzistencën e xhamive të ndërtuara në kala, është vepra e E. Çelebiut. Ja se ç' shkruan udhëtari turk në vitin 1670, kur ai vizitoi Beratin: “Në kalanë e brendshme ka gjithsej 40-50 shtëpi të mbuluara me tjegulla dhe një *xhami të Bajazit Hanit*”.⁵⁶ Më poshtë duke përshkruar pjesën e poshtme të kalasë së madhe të Beratit shkruan: “Ka gjithsej 200 shtëpi të shkatërruara me tjegulla... Ka një *xhami të Bajazit Hanit*, një faltore e vjetër e mbuluar me tjegulla dhe me minare qargjir. Është ndërtesë e vjetruar, pa xhemat, (lexo: pa besimtarë – F.D.). Është një xhami e çuditshme”⁵⁷. Më tutje, duke folur për xhamitë e Varoshit të qytetit, shton edhe se “në kalanë e sipërme ndodhet *xhamia e Hynqarit* (e sulltanit- F. D.), së cilës i thonë *xhamia Fet'hije*”.⁵⁸

fl. 842-843; dos. 5/A, fl.5; *Ankara Vakıflar Genel Müdürlüğü Arşivi*, Hurufat Defterleri, f. 2, 5.

⁵⁴ Aleksandër Meksi, *vep. e përm.*, f. 204; Apollon Baçe, Aleksandër Meksi, Emin Riza, *vep. e përm.*, f. 67-68.

⁵⁵ *Po aty.*

⁵⁶ Evlija Çelebi, *Seyyahatnamesi*, f.690.

⁵⁷ *Po aty.*

⁵⁸ *Po aty.*, f. 694.

Nga informatat e Çelebiut mund të mendohet se kemi të bëjmë me tri xhami dhe jo me dy, sikurse është thënë deri tani.⁵⁹ Për vetë faktin që sot ruhen gjurmë vetëm të dy xhamive, të ndërtuara në kala, nuk mund të injorojmë njoftimet e Çelebiut për ekzistencën e tri xhamive në kohën e tij. Sipas mendimit tonë, duke u mbështetur gjithnjë në të dhënat e autorit të mësipërm, dy xhamitë e ruajtura deri më sot me emrat Xhamia Fet'hije ose e Hynqarit në akropolin e kalasë (Yukaru kıla'da) dhe xhamia e Bajazit Hanit pranë akropolit, gjithnjë në kalanë e brendshme (iç hisar). Kjo kuptohet nga përkimi i vendodhjeve të gjurmëve të sotme të këtyre objekteve dhe të atyre të përcaktuara prej Çelebiut. Duke u nisur nga ky realitet, xhamia tjetër e Bajazitit, të cilën Çelebiu e vendos në pjesën e jashtme të Kalasë së Beratit, duket se s'ka mundur të arrijë deri në kohën e sotme, qoftë edhe në formën e një rrënoje. Kjo edhe për arsyen e thjeshtë se nga një ndërtesë e vjetruar, siç paraqitej ajo në shek. XVII, vështirë se mund të mbetej ndonjë shenjë e saj deri në kohën e sotme. Në këto kushte nuk na duket me vend që studiuesit e kanë konfunduar këtë xhami (sot inekzistente) me xhaminë e Bajazitit në kalanë e brendshme, pranë akropolit, duke përdorur karakteristikat e kësaj të fundit (të dhënë prej Çelebiut) për të analizuar e përshkruar të parën. Për më tepër, në formulimin e përfundimeve të tyre jobindëse ka ndikuar edhe përkthimi i pasaktë i përshkrimeve të Çelebiut në lidhje me xhaminë e vjetër në kalanë e jashtme, duke pohuar se autori në fjalë ka thënë se kjo xhami qenkësh “e vetmuar dhe e çuditshme”⁶⁰, kur në të vërtetë ai s'e përdor fare fjalën “e vetmuar”, por vetëm cilësorin “e çuditshme” (shih përkthimin më lart).

Po ashtu, pa dashur të përfshihemi në diskutime për kohën e ndërtimit të xhamive në kala, çështje e cila ka ngjallur kundërtënie midis historianëve të arkitekturës (sidomos koha e ndërtimit të Xhamisë së Kuqe), pa dashur gjithashtu të marrim përsipër gjykimin e argumenteve që mbështeten në veçoritë tipologjike arkitektonike të dy xhamive,

⁵⁹ Gj. Frashëri dhe S. Dashi në një studim të tyre mbi zhvillimin e arkitekturës islamike në Shqipëri kanë pohuar se në Kalanë e Beratit ai (E. Çelebiu – F.D.) ka parë dy faltore islamike, njëra pranë akropolit, e quajtur xhamia e Bajazit Hanit dhe tjetra brenda në akropol e quajtur xhamia e Hynqarit, që i thonë ndryshe edhe “Fotëhije” (është shkruar gabim, duhet “Fet'hije”-F.D.). Shih: Gjergj Frashëri, Sulejman Dashi, “Zhvillimi i arkitekturës islamike shqiptare të xhamive (probleme të periudhizimit)”, *Monumentet*, Tiranë: 1986, nr. 2, f. 55.

⁶⁰ Shih: Gjergj Frashëri, Sulejman Dashi, *vep. e përm.*, f. 55.

gjurmë të të cilave ruhen edhe sot (ç'ka është jashtë kompetencave tona profesionale), mendojmë se do të ishte e lejueshme të tërheqim vëmendjen në ndonjë aspekt të natyrës historike.

Për të dëshmuar hershmërinë e Xhamisë së Kuqe (ndërtimi i saj lidhet me kohën e Bajazitit I (Jëlldërëmit), ndonjë autor thërret në ndihmë të arsytimit të tij edhe interpretime të pasakta që ata u kanë bërë njoftimeve të Çelebiut për xhaminë e vjetër, të ndërtuar në pjesën e kalasë, njoftime që, siç u tha më lart, edhe pse lidhen me këtë të fundit, i janë adresuar padrejtësisht Xhamisë së Kuqe në kalanë e brendshme. Kështu që, ndërsa Çelebiu s'përmend fare ndonjë "stil antik" kur flet për karakteristikat e ndërtimit të xhamisë së vjetër në pjesën e jashtme të kalasë, është thënë pa të drejtë se ai e dallon këtë ndërtesë nga xhamitë e tjera të Beratit "për stilin antik të saj".⁶¹

Meqenëse dëshmitë materiale të xhamive të kalasë që kanë mbërritur deri në kohët tona vështirë se mund të mjaftonin për të gjykuar për kohën e ndërtimit të tyre, disa mendime mund të jepen vetëm duke u mbështetur në veprën e Çelebiut. Duke u nisur nga vendndodhja (brenda në kështjellë) dhe emri që mban (Fet'hije), d.m.th. që lidhet me kohën e pushtimit, del se Xhamia e Bardhë ose e Hynqarit (Sulltanit-F.D.) duhet të jetë xhamia më e vjetër e Beratit.⁶² Kjo mund të thuhet për më tepër se xhamitë e para, në qytetet shqiptare, osmanlinjtë i ndërtuan menjëherë pas pushtimit të tyre, që t'u shërbenin nevojave fetare të ganizoneve ushtarake që u vendosën në kalatë e qyteteve. Kështu ndodhi me Beratin në kështjellën e të cilit, menjëherë pas pushtimit (viti 1417), u ndërtua xhamia Fet'hije (Xhamia e Bardhë). Rreth këtyre viteve duhet të jetë ndërtuar si rregull kjo xhami dhe jo në vitet 60 të shek. XV, siç është pohuar në ndonjë studim mbi arkitekturën islamike në Shqipëri, të cituar më parë.⁶³

⁶¹ *Po aty*, f. 56.

⁶² Në të njëjtin përfundim vjen edhe studiuesi A. Meksi, i cili nisët thjesht nga fakti se kjo xhami ndodhet brenda kështjellës dhe si e tillë i shërbente garnizonit dhe administratës osmane të qytetit. Shih: Aleksandër Meksi, "Rreth arkitekturës së xhamive të shek.XV-XVI", *Monumentet*, Tiranë: 1987, nr.1.

⁶³ Në artikullin e përmendur shënimi i Gj.Frashërit dhe S.Dashi, duke konsideruar gabimisht emërtimin "Fet'hije" që bartnin xhamitë, ndërtimi i të cilave lidhej me kohën e pushtimit të qendrave ku ato ndërtoheshin, si term që lidhej me emrin e sulltan Fatihut, janë përpjekur që të gjitha xhamitë me emërtimin e sipërpërmendur t'i lidhnin me kohën dhe me emrin e këtij sulltani.

Duke qenë Xhamia e Bardhë e para në radhën kronologjike të ndërtimit të xhamive të Kalasë së Beratit, vetvetiu vijnë në përfundimin se dy xhamitë e tjera, që Çelebiu i përmend me emrin e Bajazit Hanit, janë ndërtuar në kohën e sundimit të Bajazitit II, duke qenë në të njëjtin mendim me studiuesin A. Meksi (me dallimin që ky autor ka parasysht vetëm një xhami me emrin e sulltan Bajazitit II dhe pikërisht xhaminë e mbiquajtur “të kuqe”, ndërsa ne, duke u nisur nga të dhënat e Çelebiut, kemi parasysht se ekzistonin dy xhami me këtë emër: Xhamia e Kuqe në kalanë e brendshme dhe xhamia tjetër “e vjetruar” në pjesën e jashtme të kalasë, e cila sot ka humbur çdo gjurmë të ekzistencës së vet.

Fakti që kemi tri xhami në qytetin e Beratit me emrin e Bajazitit II, dy në kala dhe një në Varosh, nuk duhet të na habitë, kur dihet se sulltani në fjalë jo vetëm që u shqua gjatë sundimit të vet për themelimin e shumë institucioneve fetare në territorin e Perandorisë (për çka mori edhe titullin “Veli”-i shenjtë),⁶⁴ por pati edhe rastin të përshkojë një pjesë të mirë të viseve shqiptare për hir të mbikëqyrjes nga afër të veprimeve luftarake në këto anë.⁶⁵

Krahas ndërtimit të xhamive, në qytetin e Beratit vijonte edhe ndërtimi i *medreseve* (*daru'l ulum-i talebân*). Deri në vitin 1670 ekzistonin pesë medrese, nga të cilat më të rëndësishme ishin medreseja e Zguros dhe ajo e sulltan Bajazit Veliut⁶⁶, të ndërtuara pranë xhamive me të njëjtin emër. Në dekadat e fundit të shek. XVII u ndërtua pranë xhamisë së Hysen Pashës në mëhallën Murat Çelebi, medreseja më e madhe e qytetit të Beratit, medreseja e Sali Beut. Ai e ndërtoi medresenë në fjalë së bashku me gruan e tij, Aishe Kadënën. Sipas një vakëfnameje (akt juridik me anën e të cilit njerëz të ndryshëm blatonin si vakëf pasuri të tyre në dobi të institucioneve fetare islamike kundrejt kushteve të përcaktuara-F.D.) të lënë prej kësaj të fundit, medreseja përbëhej prej 10 dhomash fjetjeje (hücre) dhe një auditori për mësim.⁶⁷

⁶⁴ Shih midis të tjerave: Şemsettin Sami Fraşeri, *Kamus'ul-Alam*, cilt.2, f. 1232.

⁶⁵ Përhapja e emrit të këtij sulltani në onomastikën shqiptare dëshmohej edhe prej të dhënave se këtë emër e mbante si xhamia më e madhe e qytetit të Shkodrës (që ndodhej në krye të Pazarit) ashtu edhe një mëhallë e këtij qyteti, një xhami në kështjellën e Gjirokastrës etj. Shih: Evlija Çelebi, *Seyyahatnamesi*, cilt 6; Dersaadet (Istanbul) 1318/1902, f. 109.

⁶⁶ *Po aty*, f. 694.

⁶⁷ *AQSH*, Fondi 128, dos.15, fl.54; dos.10, fl.16.

Për fat të keq, asnjë prej këtyre medreseve nuk ka arritur deri në ditët tona. Deri vonë është ruajtur një medrese në zonën pranë Xhamisë Mbret në anën jugore të kompleksit. Ndonëse e transformuar ngaqë është përdorur për funksione të ndryshme nga qëllimi fillestar, ndërtesa e medresesë në fjalë lejon të mendohet se ndërtimi i saj është bërë sipas skemës tradicionale të medreseve osmane. Ajo është një ndërtesë e thjeshtë, e mbuluar jo me qemerë por me çati me strukturë druri. Ajo përbëhet nga dhomat për nxënësit dhe sallat e mësimit. Dhomat përpara kishin hajate me kolona e harqe, prej të cilave deri vonë ruhej vetëm harkada perëndimore. Secila dhomë kishte oxhakë për ngrohje. Sallat dhe dhomat ishin të shtruara me dërrasa, ndërsa oborri ka qenë shtruar me rrasa guri të zeza.⁶⁸ Duke u nisur nga veçoritë e ndërtimit, është arritur në përfundimin se medreseja në fjalë përfaqëson një objekt të fundit të shek. XVII – fillimi i shek. XIX.⁶⁹ Ndoshta i kësaj kohe mund të jetë rindërtimi i kësaj medreseje, sepse ka të dhëna dokumentare që kohën e ndërtimit të saj e shpjen shumë përpara. Një ferman i sulltanit, shpallur në vitin 1716 në lidhje me konfirmimin në detyrë të mësuesit të këtij institucioni (müderris-i âm), tregon se medreseja, e themeluar prej bamirësit Mehmet Efendiu, mund të ishte ndërtuar që në shek. XVII.⁷⁰

Për sa i përket ndërtimit të teqeve ose të zavijeve, duket qartë se gjatë shek. XVII ato ishin shtuar me shpejtësi në qytetin e Beratit, varësisht nga përhapja në këtë qytet e sekteve të ndryshme të dervishëve (teke-i dervişân, erbab-i tarik, tarik-i ziş’şan). Tri teqetë kryesore të këtij qyteti përmenden prej Çelebiut dhe dokumenteve osmane të kohës. Në rend të parë vinte teqeja e sektit islamik të *halvetinjve*, që ndodhej përpara mihabit të Xhamisë Mbret (në anën lindore të kësaj xhamie). Teqeja në fjalë ishte ndërtuar me një stil të panjohur në këto anë. Në anën e djathtë të xhamisë teqeja kishte 40 dhoma për strehimin e dervishëve. Ndërtesa e teqesë së halvetinjve, sipas Çelebiut, ishte me planimetri tetëkëndëshe, me dy kate (fevkani ve tahtani).⁷¹ Mund të mendohet se për këtë është fjala kur në dokumentet e kohës përmendet zavija e themeluar prej sheh

⁶⁸ Apollon Baçe, Aleksandër Meksi, Emin Riza, *vep. e për.*, f. 70.

⁶⁹ *Po aty*.

⁷⁰ *AQSH*, Fondi 128, dos.109, fl.6.

⁷¹ Evlija Çelebi, *Seyyahatnamesi*, cilt 8, f. 694-695. Shih edhe: Apollon Baçe, Aleksandër Meksi, Emin Riza, *vep. e për.*, f. 70.

Bajazit Efendiut në Mëhallën e Vjetër (Mëhalla e Xhamisë Mbret- F. D.).⁷²

Teqeja e Halvetinjve do të rindërtohej më vonë, në vitet 1781-1782, prej sundimtarit të Beratit Ahmet Kurt Pashës, gjë që dëshmohet prej tekstit të kronogramit prej tri vargjesh, gdhendur në rrasën prej mermeri të bardhë të vendosur mbi derën e ndërtesës.⁷³

Në qendër të saj ndodhet salla e lutjeve, me të cilën bashkëngjitej mjedisi ku është varrosur Ahmet Kurt Pasha. Në pjesën e përparme paraprin hyrjen për në sallë një portik i hijshëm. Salla e lutjeve ka planimetri katrore. Në faqen perëndimore të saj ka tri dritare që shohin në portik. Në murin lindor ndodhet mihrabi me zbukurime në formë stalaktitesh. Në të dy anët e mihrabit janë dy dritare që shohin në drejtim jugor. Në anën veriore dhe lindore salla e lutjeve ka një mafil-ballkon, në të cilin hipet nga ana e jashtme. Muratura e teqesë është prej guri të lidhur me llaç gëlqereje. Teqeja e Halvetinjve përfaqëson një objekt të ndërtuar me mjeshtëri të lartë.⁷⁴

Teqe tjetër jo pa rëndësi duhet të ketë qenë edhe ajo e Ahmet Bej Zguros (Uzkurlu tekasi), e ndërtuar ndoshta pranë xhamisë me të njëjtin emër⁷⁵. Në dokumentet osmane të kohës përmenden edhe teqe ose zavije të tjera, si teqeja e sheh Musa Efendiut⁷⁶, teqeja e Hajredin Efendiut⁷⁷, zavija e themeluar prej Hysen Çelebiut në mëhallën Baba Kadi etj.⁷⁸ Po në këtë mëhallë ishte ndërtuar edhe teqeja e sheh Mustafa Efendiut (sekti i Kadirinjve), e cila mbante emrin e sheh Ibrahim Efendiut.⁷⁹ Duke qenë

⁷² AQSH, Fondi 128, dos.37, fl.48.

⁷³ Vehxi Buharaja, *Mbishkrime turko-arabe në Shqipëri* (dorëshkrim në AIH, f.49-50). Përndryshe në tekstin prej 13 distikësh të një kronogrami tjetër të zbuluar në pjesën e sipërme të veshjeve prej druri të teqesë së halvetinjve, tekst i shkruar me bojë ngjyrë trëndafili të errët, jepet si kohë ndërtimi viti hixhri 1197(1782-1783), ndoshta sepse punimet e brendshme në këtë objekt kanë mbaruar një vit më vonë (Shih: *Po aty*, f. 51-53).

⁷⁴ Më hollësisht për karakteristikat arkitekturore të teqesë së halvetinjve të Beratit shih analizën e bërë prej A.Meksit në: Apollon Baçe, Aleksandër Meksi, Emin Riza, *vep. e përm.*, f. 71-72.

⁷⁵ Edhe kjo teqe përmendet prej Çelebiut, por pa dhënë ndonjë informatë për të. Shih: Evlija Çelebi, *Seyyahatnamesi*, cilt 8, f.695.

⁷⁶ AQSH, Fondi 128, dos. 37, fl.11.

⁷⁷ AIH, L.854 (S. 131/3), dos.3, fl.822.

⁷⁸ AQSH, Fondi 128, dos.37, fl.822.

⁷⁹ *Po aty*.

se në ditët tona nuk kanë mbërritur gjurmët e këtyre monumenteve të kultit islamik, asnjë fjalë nuk mund të thuhet për karakteristikat ndërtimore të tyre.

Në sistemin e teqeve të qytetit të Beratit një vend të veçantë zë edhe teqeja e Rufaive në pjesën perëndimore të mëhallës Murat Çelebi. Hulumtimet epigrafike kanë zbuluar si kohë të ndërtimit të saj vitin hixhri 1197/1782-1783. Mbishkrimi prej katër vargësh, i gjetur mbi derën e kësaj teqeje prej orientalistit V. Buharaja, na bën të ditur se ndërtuesi i saj ishte qehajai i Kurt Ahmet Pashës.⁸⁰ Teqeja e Rufaive në vetvete përfaqësonte një ndërtesë të mbuluar me çati druri dhe të përbërë nga salla e lutjeve, portiku përpara saj dhe minarja.⁸¹

Në shek. XVII në Berat ishin ndërtuar edhe tri imarete, institucione islamike të bamirësisë, të cilat për atë kohë luanin rolin e asistencës sociale për popullsinë e qytetit. Në imarete shpërndahej falas ushqimi për të vobektit. Ato ishin ngritur pranë xhamive të qytetit: njëra pranë Xhamisë Mbret, tjetra pranë Xhamisë së Zguros, ndërsa e treta thuhet se ishte themeluar prej Azis Efendiut.⁸² Për këtë të fundit nuk dimë se në ç'vend ishte ndërtuar.

Gjithashtu, Çelebiu na bën të ditur praninë në qytetin e **Vlorës** të shumë objekteve të kultit islam, midis të cilëve përmend xhaminë e sulltan Sulejmanit, si një monument që binte në sy me kubën e saj prej guri të mbuluar me plumb dhe me një minare të shembur. Veç kësaj, i njëjti burim përmend edhe xhaminë e Mumxhuzadesë, të mbuluar me tjegulla dhe me minare me gurë të gdhendur, xhaminë e Hysen Agait me të njëjtat karakteristika, tri medrese, tri teqe etj. Midis këtyre të fundit përmenden teqeja xhelvetiane e Jakup Efendiut, me qindra dervishë, si dhe teqeja bektashiane e Baba Sulltanit, e quajtur ndryshe Kuzgun Baba (brenda në ullishtë, sot: Kuz Baba-F.D.)⁸³. Prania e bektashizmit në

⁸⁰ Teksti i plotë i mbishkrimit është ky: “I zoti i veprave të mira dhe humanitare, qehajai (ket’hydai) i shkëlqesisë së tij Kurt Ahmet Pashës, Ibrahim, i biri i Ahmet Sollakut, viti 1197/1782-1783”. Shih: Vehxhi Buharaja, *Mbishkrime turko-arabe në Shqipëri*, f.58.

⁸¹ Më hollësisht shih përshkrimin e bërë prej A.Meksit në: Apollon Baçe, Aleksandër Meksi, Emin Riza, *vep. e përm.*, f.72.

⁸² Evlija Çelebi, *Seyyahatnamesi*, cilt 8, f. 697.

⁸³ *Po aty*, f.705-706; *Po ai, Shqipnija para dy shekujsh*, Tiranw: Shkodra, 1930 (pwrkthyer nga Salih Vuçiterni), f. 82; Robert Dankoff-R. Elsie, *Evliya Çelebi in Albania and adjacent regions*, Leiden-Boston-Köln: Brill, 1999, f.138-141.

mesin e besimtarëve myslimanë të Vlorës në këtë kohë ishte një fakt i pamohueshëm, një tipar themelor i pamjes fetare të qytetit, përderisa E. Çelebiu, kur fliste për mungesën e ujit të pijshëm në qytet, shprehte dëshirën që me pak shpenzime, një bamirës të mund të kënaqte shpirtrat e “dëshmorëve të Qerbelasë”, (është fjala për banorët myslimanë të urdhrit bektashian-F.D.), d.m.th të zgjidhte problemin e ujit për qytetin.⁸⁴

S u m m a r y

THE CHANGES OF THE URBAN AND ARCHITECTURAL STRUCTURES IN THE ALBANIAN TOWNS DURING THE OTTOMAN PERIOD: ORIENTAL AND ISLAMIC DIMENSIONS (XVI-XVII CENTURIES)

The great changes that happened in the political and economic life, as well as, in the demographic and religious structure in the Albanian territories during the XVI and XVII centuries, had a significant impact on the new features of the urban developments and architectural peculiarities of the time. The main characteristic of these developments is the birth and advancement of the Oriental Islamic features as an important part of the urban composition of the time. In order to make this study comprehensible and to simplify the methodology used, my observations and analysis will focus on three important towns in south Albania, namely Berat, Vlore and Gjirokaster, which were under the jurisdiction of the Vlora prefecture (Avlonya livası).

The fast Islamisation process would give a new look to the Albanian urban centers. The view of the towns would acquire distinct and very important features, taking into account here, not only the new neighborhoods where the newly converted Islamic population was allocated, but also the Islamic buildings erected in the three above mentioned towns.

The names of these new neighborhoods reflect the political, economic and social changes that had already started in the Albanian towns of this period. Some of these neighborhoods were named after prominent people or people from the political and religious hierarchy and some others named after certain crafts.

⁸⁴ Evlija Çelebi, *Seyyahatnamesi*, cilt 8, f.707.

